

# REPUBLIKA E SHQIPERISE



## Bashkia Kruje

---

### TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE PER VITIN 2017

Ne mbeshtetje te ligjit nr. 139/2015 “Per vet qeverisjen vendore” , Ligjit nr. 9632, date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore” i ndryshuar,ligjit 142/2015, Ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, Ligji nr. 9975 date 28.07.2008 “Per taksat kombetare” i ndryshuar, Ligji nr. 107/2014, “Per Planifikimin e territorit” , Ligji nr.10 465 date 29.09.2011 “Per “Sherbimin veterinar ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar,ligjit nr 8318 date 01.04.1998 “ Per dhenjen me qera te tokes bujqesore, pyjore,livadheve e kullotave pasuri shteterore”i ndryshuar,ligjit nr 9385 date 04.05.2005 “Per pyjet dhe sherbimin pyjor” i ndryshuar, VKM nr 391 date 21.06.2006 “Per percaktimin e tarifave ne sektorin e pyjeve dhe kullotave” i ndryshuar,VKM nr 460,date 22.05.2013 “Per percaktimin e kriterëve rregullave dhe procedurave te dhenjes me qera te tokave bujqesore ne pronesi te shtetit”,ligjit 152 dt 21.12.2015 “ Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi” dhe Vendimit 285, date 27.06.2002. “ Per tarifate sherbimeve qe kryhen Policia e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimit ndaj shtetasve dhe personave, juridike e fizike, vendas e te huaj,legjislacionit te aplikueshem ne fuqi, akteve nenligjore te miratuara ne baze dhe per zbatim te ligjeve te sipercituara, bazuar ne Relacionin e hartuar nga grupi i punes per pergatitjen e paketes fiskale per vitin 2017 e vijim, Kryetari i Bashkise

#### Hyrje

Paketa fiskale percakton nivelin e taksave dhe tarifave vendore,llojet, baza tatimore, kategorizimet dhe nenkategorizimet, kestet e pagimit, koha e kryerjes se tyre, kushtet lehtesuese dhe strukturat e ngarkuara te Bashkise Kruje per vjeljen e tyre.

#### TAKSAT VENDORE

##### 1.TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PER BIZNESIN E VOGEL

Çdo subjekt, i cili kryen një aktivitet, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin vogël.

Të ardhurat gjithsej nga veprimtaria e biznesit të vogël nënkuptojnë çdo lloj të ardhure, të realizuar gjatë periudhës tatimore dhe përfshijnë, pa u kufizuar vetëm në to, të ardhurat e realizuara nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, të ardhurat nga pjesëmarrjet, të ardhurat nga interesat, të ardhurat nga shfrytëzimi i pasurisë së luajtshme e të paluajtshme.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi të ardhurat e tatueshme, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, me qarkullim :

**a) nga 5(pese) deri në 8(tete)milionë lekë, është 5 (pese) për qind .**

**b) Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0(zero) deri ne 5(pese) milionë lekë,eshte 0 lekë në vit.**

### **Menyra e pageses**

Pagesat e kesteve te tatimit te thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel me qarkullim nga 5deri ne 8 milione leke kryhen te bankat e niveli te dyte per llogari te administrates tatimore cdo vit sipas afateve:

-brenda dates 20 prill kryhet pagesa per muajt : janar, shkurt ,mars.

-brenda dates 20 korrik kryhet pagesa per muajt : prill,maj,qershor.

-brenda dates 20 tetor kryhet pagesa per muajt : korrik ,gusht, shtator.

-brenda dates 20 dhjetor kryhet pagesa per muajt :tetor,nentor,dhjetor

#### **➤ Struktura pergjegjese per vjeljen e taksës**

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore, vepron si agjent tatimor, i ngarkuar me mbledhjen, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Administrata tatimore transferon të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël në llogari të bashkive ose të njesive, ku ka vendndodhjen biznesi i taksueshëm, brenda datës 10 të muajit pasardhës, kur janë arkëtuat taksat.

Administrata tatimore, për shërbimin që kryen si agjent tatimor, merr një komision në *masën 1 %(për qind )* të shumës së tatimit që kanë arkëtuat dhe kanë transferuar në buxhetin e njësive të qeverisjes vendore

## **2. TAKSA MBI PASURINE E PALUAJTSHME**

Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë të pasurive në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive.

Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe.

Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie

Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm përperiudhën e të drejtës së pronësisë.

Siperfaqja ne pronesi e taksapaguesit percaktohet sipas dokumenteve qe vertetojne pronesine e leshuar nga Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme (ZVRPP).

Nese prona nuk eshte e regjistruar ne regjistrin e pasurive te paluajtshme, per efekt te detyrimit per pagimin e takses nga taksapaguesi, Zyrat e Taksave te bashkise, per vertetim pronesie njohin:

a) vendimet e komisionit te kthimit dhe kompesimit te prones

b) vendimet e privatizimit

c) dokumentat e tjera te leshuara nga organet perkatese shteterore ne perputhje me legjislacionit perkates.

-Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i ndërtesës bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së ndërtesës, pranë bashkisë ku ndodhet ndërtesa.”

-madhesia e siperfaqes se tatueshme percaktohet edhe me vendim nga Komisioni i verifikimit te pasurive te paluajtshme I ngritur me urdher te Kryetarit te Bashkise ne zbatim te ligjit nr.9632 date 30.10.2006 I ndryshuar .

-Ne rastet e siperfaqes se nderteses te dhene ne perdorim, nese ne marreveshjen midis pronarit dhe perdoruesit eshte percaktuar detyrimi i ketij te fundit per pagimin e takses mbi pasurine e paluajtshme, madhesia e siperfaqes se pasurise se taksueshme do te percaktohet ne baze te dokumentit (kontrate/marreveshje) te lidhur mes paleve.

-Ne rast se nje prone shtrihet ne territorin e me shume se nje bashkie ose komune, pavaresisht nga vendbanimit i pronarit, secila njesi vendore e trajton pjesen e prones, qe ndodhet Brenda territorit te vet, si prone me vete dhe zbaton mbi te dispozitat e ketij ligji.

#### ➤ **Taksa mbi mbi pasurinë e paluajtshme përbëhet nga:**

- Taksa mbi ndërtesën.
- Taksa mbi tokën bujqësore
- Taksa mbi truallin

## **2.1 TAKSA MBI NDERTESAT**

Baza e takses mbi ndertesat eshte siperfaqja e ndertimit ne meter katror e nderteses ose e pjeses se saj, mbi dhe nen nivelin e tokes dhe per çdo kat. Detyrimi per taksen llogaritet si shumezim i nivelit te takses me bazen e taksueshme, tabela nr. 1.

Taksas mbi ndertesat i nenshtrohen edhe taksapaguesit, te cilet kane, ne perdorim apo ne pronesi, ndertesat brenda teritoreve te miratuara si fshatra turistike. Siperfaqja e nderteses, ne perdorim apo pronesi, percaktohet ne baze te dokumenteve, qe vertetojne perdorimin ose pronesine e saj. Taksa mbi ndertesat llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Detyrimi per taksen llogaritet si shumezim i nivelit te takses me bazen e taksueshme, tabela nr. 1.

-Niveli i takses caktohet ne leke per meter katror. Kategorite minimale te bazes se takses dhe nivelet treguese te takses per cdo kategori minimale te bazes per taksen mbi ndertesat jane sipas nenit 22,aneksi 1 te ligjit nr 9632 dt 30.10.2006.”PER SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”i ndryshuar .

### **Kategorite dhe nenkategorite (Leke/m<sup>2</sup>/vit)**

#### **a) Ndertesat Banimi:**

- Ndertuar para 1993-shit :
- Ndertuar gjate dhe pas 1993-shit:

## **b) Ndertesa te Tjera:**

Keshilli I Bashkise ka te drejte te percaktoje + 10% deri – 30% nivelin e takses per biznesin e vogel, dhe -30 % deri ne +30% per biznesin e madh

### Ndertesa per Tregti dhe Sherbime:

Ndertesa per veprimtari prodhuese , tregti dhe sherbime, Biznes i Vogel propozojme: niveli baze (+10%)

Ndertesa per veprimtari prodhuese , tregti dhe sherbime, Biznes i Madh propozojme: niveli baze(+15%)

Ndertesa per veprimtari ( prodhuese e sherbime artizanale) , Biznes i Madh propozojme: niveli baze(+30%)

Ndertesa per veprimtari prodhuese,tregti dhe sherbime Tatimpaguesit e medhenj Biznese Vip : propozojme: niveli baze (+30%)

### Ndertesa te Tjera:

Ndertesa ne pronesi te organizatave jofitimpruese, fondacioneve.

Do të përfshihen pronat të cilat përdoren nga organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja,zyrat e përfaqësimit të organizmave ndërkombëtare, ambasadat të njohura ose të rregjistruara si të tilla në gjykatë.

Objekte të amortizuara, të dëmtuara dhe jashtë funksionit kur janë objekte të ndërmarrjeve shtetërore dhe ish-ndërmarrjeve shtetërore të privatizuara ku nuk zhvillohet aktivitet. Do të kuptojmë të gjithë objektet të cilat janë kapital i Ndërmarrjeve shtetërore dhe kanë qënë kapital i ish-ndërmarrjeve shtetëror:

- Kur është objekt i ndërmarrjeve shtetërore ekzistuese të cilat jane tërësisht te amortizuara (vlere e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatësesipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pamvarësisht nga vlere e amortizimit. Për këto 2 lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.

- Kur ka qënë objekt i ish- ndërmarrjeve shtetërore të cilat janë privatizuar (tërësisht ose pjesërisht Ndërmarrja ose vetë objekti) dhe është tërësisht i amortizuara (vlere e amortizimit mbi 80 % e vlerës fillestare dhe ndryshimeve përkatëse sipas pasqyrave kontabël) ose kur objekti është i dëmtuar pamvarësisht nga vlere e amortizimit. Për këto lloj objektesh duhet të plotësohet kushti që ato janë jashtë funksionit dhe në to nuk ushtrohet asnjë veprimtari tjetër.

-ndertesa ne pronesi te subjekteve te pashfrytezuara.

-Ndertesa ne pronesi apo ne perdorim ,ne territore te miratuara si fshatra turistike

## **Tabela 1.Nivelet treguese te takses se nderteses Bashkine Kruje**

Kategorite dhe nenkategorite	Vlera leke/m2
<b>I NDERTESA BANIMI</b>	
Ndertesa te ndertuara para vitit 1993	5
Ndertese te ndertuar gjate dhe pas vitit 1993	6
<b>II NDERTESA TE TJERA</b>	
Ndertese , tregti dhe sherbime	200
Ndertese qe perdoren per vep.prodhuese,	100
Ndertesa te tjera	40
<b>III:Ndertesa ne pronesi apo ne perdorim ,ne territore te miratuara si fshatra turistike.</b>	400

Shenim I. Tatimpaguesit qe kane ne pronesi me shume se nje banese ,per shtepine ku kane banimin e zakonshem paguajne taksen e ndertesës ,sipas aneksit 1 te ligjit nr 9632 “Per sistemin e taksave vendore” te ndryshuar,ndersa per te gjitha shtepite e tjera ,taksa e ndertesës eshte sa dyfishi i taksës ndertesës ,qe zbatohet ne zonen ku ndodhet kjo ndertese.

-Cdo posedues pasurie duhet të paraqesë dokumentin e pronesisë mbi pasurinë që zotëron, në të kundërt pagesa do kryhet duke marrë për bazë sipërfaqen prej 100 m2 për cdo rast.

Shënim II: Në të gjitha njësitë administrative të tjera ish komuna, niveli tregues i taksës për çdo kategori minimale të ndërtesës është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës të kategorisë minimale të ndërtesës në njësitë administrative të përcaktuara në tabelë

Shenim III: Për ndërtesat në pronësi të shoqërive të ndërtimit, të destinuara për shitje, por që janë ende të pashitura, taksa do të vendoset sipas destinacionit të përdorimit të ambientit të ndërtesës.

Ambientet e hipotekuara, si:

- apartamente banimi do t’i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “Ndërtesa banimi”;
- ndërtesë biznesi do t’i nënshtrohen taksës mbi ndërtesat në kategorinë “Ndërtesa të tjera për tregti dhe shërbime”.

## Mënyra e pagesës:

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me nje kest. Afati i pagesës per kategoria II+III eshte data 30.04.2017.

Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas kesaj date është 60 ditë pas lindjes së detyrimit.

**Perfitojne 20% ulje te gjitha subjektet qe paguajne kete takes brenda dates 30.03.2017**

## **PERJASHTIMET NGA TAKSA MBI NDERTESEN**

Perjashtohen nga taksa:

- pronat e shtetit dhe te njesive te qeverisjes vendore, qe perdoren per qellime jofitimpruese;
- ndertesat e banimit, qe shfrytezohen nga qiramarresi me qira te paliberalizuara;

- ndertesat qe perdoren nga komunitetet fetare, shoqata bamiresie ( qe jane ne ndihme te femijeve jetime e familjeve ne nevoje).
- pasurite ne pronesi te shtetit, te kaluara me vendim te Keshillit te Ministrave, nen administrimin e shoqerive publike shteterore.

Perjashtohen dhe Lehtesohen nga taksa :

- Familjet qe kane k/familjarin invalidë te punës, invalidë të luftës;
- Familjet e veteraneve te luftes:familjet e deshmorëve te Atdheut
- Familjet qe kane ne perberjen e tyre të verbërit, të sëmurët, paraplegjikë dhe tetraplegjikë , si individë;
- Familjet qe janë perfituese të ndihmës ekonomike.
- Pensionistet e vetem ose me persona madhore te papune.
- Taksapaguesi, pasuria e te cilit eshte demtuar nga veprimi i forcave madhore.

*Ne kete rast, lehtesimi ose perjashtimi eshte i perkohshem dhe kohezgjatja percaktohet nga keshilli bashkiak, ne raport me demin e shkaktuar deri ne vleren 75 per qind.*

- Për të përfituar nga përjashtimi, këto familje duhet të dorëzojnë në drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë dokumentat dokumentat e mëposhtëm.

- Librezën përkatëse;
- Vërtetimin e papunësisë nga zyra e punës
- Vërtetimin e përfitimit të ndihmës ekonomike
- Vendimi i keshillit bashkiak (ne rastin e demtimit)

➤ **Struktura pergjegjese per vjeljen e taksës**

***Struktura e ngarkuar per vjeljen e taksës mbi ndertesat eshte Drejtoria e Tatim Taksave Vendore, prane Bashkise .***

## **2.2Taksa mbi token bujqesore.**

Sipas ligjit 9632, date 30.10.2006

Neni 23, ku thuhet baza e taksës mbi token bujqesore eshte siperfaqja e tokes bujqesore ne Hektar ne pronesi dhe ne perdorim te taksapagusit .

Kategorite minimale jepen aneksin nr.2 te ketij ligji si me poshte:

**Tabela nr2 Vlera e taksës ne leke /hektar /vit ne Bashkine Kruje.**

Klasifikimi sipas kategorise se tokes	Vlera e taksës ne lek /hektar ne Vit
Kategoria I	5600
Kategoria II	4900
Kategoria III	4200
Kategoria IV	3600

Kategoria V	3000
Kategoria VI	2400
Kategoria VI-X	1800

Keshilli bashkiak ka te drejte te aplikoje (+10%) e (-30%) mbi nivelin baze.

Mendojme te aplikohet (-30%) per familjet qe jetojne nen minimum jetik.

Perjashtohen nga taksa mbi token bujqesore, tokat qe mbillen me kultura drufutore dhe vreshtari per 5 (pese) vitet e para nga casti i mbjelljes.

- **Struktura e ngarkuar per vjeljen e kesaj takse eshte Drejtoria ATAP prane Bashkise ne bashkepunim me Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, prane Bashkise .**

## 2.3 Taksa mbi truallin

Sipas ligji142/ 2015, per disa shtesa e ndryshime ne ligjin nr 9632, date 30.10.2006 “Per sistemin e taksave vendore” te ndryshuar

“Truall”, një sipërfaqe toke, jo tokë bujqësore, që ndodhet brenda vijës kufizuese të ndërtimit, e përcaktuar nëpërmjet dokumenteve ligjore të planifikimit, të e miratuar për të ndërtuar mbi të.”.

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në hektar, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.

Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli.

2. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2.1,të këtij ligji.

**Tabela nr 3. Niveli i taksës se truallit**

Klasifikimi sipas Njesive	Vlera e taksës ne leke /m2 /vit per qellime banimi nga individet.	Vlera e taksës ne leke /m2 /vit per qellime biznesi .
Bashkia dhe Njesite Administrative	0.56 Lek m2	20 Lek m2

- **Struktura e ngarkuar per vjeljen e taksës mbi ndertesën dhe taksës mbi Truallin eshte DTT Vendore, prane Bashkise Kruje.**

## 3.TAKSA E FJETJES NE HOTEL

Janë subjekt i taksës të gjithë hotelet, motelet, stabilimentet turistik, pensionet, shtëpitë e pritjes, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë ushtrim veprimtarie.

- Baza e taksës së fjetjes në hotel është numri i netëve të qëndruara në hotel.
- Niveli tregues i taksës është sipas ligjit 142/2015 aneksi 8 bashkëlidhur këtij ligji.

**Tabela nr4 Niveli i taksës se fjetjes ne hotel**

Kategorite	Lek per nate fjetje
HOTELE 4-5 YJE	105
Bujtinë, fjetinë, motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin	35

Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së miratuar nga Bashkia, për natë qëndrimi, me numrin e netëve të qëndrimit në hotel

#### **Mënyra e pagesës:**

Pagesa kryhet brënda datës 5 të muajit pasardhës.

Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të Bashkisë dhe evidentohet në faturën e hotelit ku shënohet cmimi i fjetjes dhe vlera e taksës.

#### **❖ Struktura pergjegjese per vjeljen e takes se fjetjes ne hotel**

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është DTT Vendore pranë Bashkisë Kruje.**

## **4.TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURE NGA NDERTIMET E REJA**

- Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri.

Klasifikimi si investim i ri dhe vlerat perkatese percaktohen ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhenien e lejes se ndertimit/zhvillimit, sipas parashikimeve te Ligjit 107/14, "Per planifikimin e territorit" .

-Detyrimi per taksen i takon investitorit.

Këshilli bashkiak miratoi kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve, të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës.

Niveli i taksës sipas kategorive dhe nenkategorive per klasifikimin e investimeve (jo shteruese sipas Lejeve ne tabelen me poshte), eshte si me poshte:

**Tabela nr 5: Niveli i takse se ndikimit ne infrastrukture**

	<b>Kategorite dhe nenkategorite</b>	<b>Nivelitaksës</b>
1	Leje zhvillimore ndertimi per godina banimi ,garazhe dhe bodrume	4% E cmimit te shitjes
2	Leje zhvillimore ndertimi per objekte njesi sherbimi dhe prodhimi	E cmimit te shitjes 6%
3	Leje zhvillimore ndertimi te vecanta( turizem,industri,publik)	e vleres se investimit 5%



4	Leje zhvillimore ndertimi për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroportëve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte,	0.1% e vleres invest.
5	Per ndertesa ne proces legalizimi	0.5% e vleres invest.
6	Per leje perdorimi per objektet me karakter banimi	15% E lejes ndertimit.
7	Per leje perdorimi per objektet me karakter prodh,sherb,treg	20% e lejes ndertimit
8	Leje zhvillimore ndertimi per qellime me interes publike, kopshte, çerdhe, shkolla, rruge komunitare (private dhe shtetore), ujsjelles kanalizime	1% e vleres invest.

### **Shenim:**

#### **Per kategori 1, 2 sipas tabelës.**

Baza e taksës është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njësive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi.

Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.

#### **Per kategorine 4 sipas tabelës**

Taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kostoja e rehabilitimit nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

#### **❖ Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës ;**

***Struktura e ngarkuar për përlogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është DPKZHT pranë Bashkisë Kruje.***

***Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës është DTT Vendore pranë Bashkisë Kruje***

## **5.TAKSA E KALIMIT TE SE DREJTES SE PASURIVE TE PALUAJTESHME**

1. Taksa mbi kalimin e se drjtes se pronesise per pasurite se palujtshme vendoset per ndertesat dhe te gjitha pasurite e palujtshme ne castin e kalimit te se drejtes se pronesise mbi to .

Taksa paguhet nga personi , qe kalon te drejten e pronesise mbi pasurine e palujtshme, para kryrjes se rregjistrimit , ne perputhje me aktet lijqore ne fuqi.

- 2- Baza e taksës mbi kalimin e se drejtes se pronesise per ndertesat eshte siperfaqja e ndertimit , pronesia e se ciles transferohet . kategorite e ndertesave Per efekt te bazes se taksushme , jepen ne aneksin nr. 3 te ligjit 9632 date 30.10.2006 , “ per sistemin e taksave vendore “ i ndyshuar .Niveli i taksës caktohet ne leke per meter katror te bazes se taksës . Detyrimi tatimor llogaritet si shumezimi i nivelit te taksës me bazen e tij.

- 3- Baza e taksës së kalimit të pronësive për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës caktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind. Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzimi i nivelit të taksës me bazën e tij.

Aneksi 3

Tabela nr6 Nivelet e taksës së kalimit të pronësive mbi ndërtesat.

Kategoritë e ndërtesave	Vlera e taksës në lek/m <sup>2</sup>
Ndërtesa banimi	100
Ndërtesa të tjera tregëti e shërbime	300
Ndërtesa të tjera	200

❖ **Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës :**

**-Struktura e ngarkuar për përlogaritjen e kësaj takse është Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Krujë në cilësinë e agjentit tatimor i cili përfiton 3% të shumës arketuar, në bashkëpunim me Drejtorinë e Tatim-Taksave Vendore pranë Bashkisë Krujë si struktura e ngarkuar për arketimin e kësaj takse.**

## 6. Taksa e Tabeles

Mbeshtetur në ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" I ndryshuar dhe ligjin 142/2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin në ligjin 9632 dt 30.10.2006." PER SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE" i ndryshuar, neni 17, aneksi 7 i këtij ligji.

Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet të cilët vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë, në hapësira të tjera publike ose private, qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime reklamimi.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve dhe subjekteve që ushtrojnë aktivitet në fushën e transportit dhe profesioneve të lira.

**Tabela nr ,Kategoritë dhe niveli i taksës jepet si në tabelën e mëposhtëme**

Kategoritë	Niveli i taksës
------------	-----------------

<p><b>1)Tabelë për qëllime identifikimi:</b></p> <p>a) Tabelë për qëllime identifikimi, <b>deri në 2 metra katror</b>, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.</p> <p>a.1) Tabelë për qëllime identifikimi <b>mbi 2 metra katror</b>, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë.</p> <p>b) Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti në formën e përmasat e tabelave të sinjalistikës për orientim.</p>	<p>0 lekë/vit</p> <p>45 000 lekë/m<sup>2</sup></p> <p>120 lekë/vit</p>
<p><b>2)Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme dhe e palëvizshme:</b></p> <p>c.1) Tabelë e thjeshtë</p> <p>c.2) Tabelë elektronike</p> <p>3) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola etj.</p>	<p>13 500 lekë/ m<sup>2</sup>/vit</p> <p>27 000 lekë/ m<sup>2</sup>/vit.</p> <p>1 000 lekë/m<sup>2</sup>/ditë</p>

Në kategorinë II: Vendosje tabelle për qëllime reklamimi (të lëvizshme dhe të palëvizshme) kuptojmë të gjithë tabelat , të vendosura në tarraca, llozhe, ballkone, në pjesë të rrugës, shtylla etj që kanë përmbajtje me qëllime reklamimi për vete ose të tretë.

**Në këtë kategori përfshihen:**

- Të gjitha reklammat statike, ndiçuese ose jo ndiçuese, faqet murale dhe autolëvizëse dhe të gjitha reklammat e lëvizshme me fletë, pamje dy ose tre vizionëshe, elektromekanike me ose pa ndiçim.
- Tabelat elektronike (të lëvizshme dhe të palëvizshme) për qëllime reklamimi: do të kuptojmë reklammat digjitale, lineare me të gjitha elementët gjysëm përçues etj.

Në kategorinë III: Vendosje tabelle në funksion apo ekspozime të ndryshme të hapura do të kuptojmë të gjithë ato tabela në funksion te panaireve të ndryshme etj. që kanë qëllim reklamimi për vete ose për të tretët.

❖ **Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës ;**

**Struktura e ngarkuar për dhënie leje për të vendosur tabelë reklamuese është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë bazuar në kërkesën e subjektit që do të vendosë tabelë reklamuese.**

**Struktura e ngarkuar për identifikim, matjen e këtyre tabelave është Inspektoriati I Mbrojtjes së Territorit.**

**Struktura e ngarkuar për vjeljen e kësaj takse është Drejtoria e Tatim-Taksave të Bashkisë Kruje.**

**Struktura e ngarkuar për penalitetet për mos pajisje me lejë për vendosje tabelle reklamuese**

është IMT.

## 7. TAKSE BAGTI E THERUR E KONTROLL VETERINAR TE KAFSHEVE TE DESTINUARA PER KONSUM PUBLIK.

Kategorite	Leke/koke
Bageti imet te therur ne thertore	50
Bageti e trashe te therur ne thertore	200
Per cdo derr te therur ne thertore	100
Tarife per leshim certifikate dalje nga tregu per cdo bageti.	200 leke/ certifikata

❖ Struktura per vjeljen e kesaj takse jane ispektoret veterinare .

## 8.TAKSË E PËRKOHSHME

### A. TAKSE PER SIPERFAQET NDIHMESE NE FUNKSION TE AKTIVITETI.

KESHILLI Bashkiak kur e shikon te domosdoshme mund te vendose taksa me karakter te perkohshem ne sherbim te banoreve ne teritorit qe ka ne juridiksionin e vet .

-Taksa e siperfaqes qe shfrytezohet jashte nderteses ne pronesi te subjektit qe perdoret ne sherbim te prodhimit ose tregimit .

- Siperfaqe ne funksion te aktivitetit per sherbim ,tregeti e prodhim 50 leke m2 ne vit .
- Siperfaqe e lire per parkingje , rruge ambjente rekreative 50 leke m2/ne vit.
- Siperfaqe e kthyer ne sheshe ndertimi e pashfrytezyshme 10 leke m2.
- Takse e perkoshme per siperfaqet e zena si trotuare e te tjera te ngjashme me to per qellime biznesi 200 leke m2/ ne muaj .

### B. TAKSË PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKËSORE(TELEFONI, ENERGJI, TV KABLLOR, INTERNET,GAZ, etj te ngjashme)

Baza e taksës për linjat ajrore dhe nëntokësore është gjatësia lineare për kilometër e linjave ajrore dhe nëntokësore e cila vihet në shfrytëzim nga subjekte për qëllime biznesi. Taksa llogaritet si detyrim vjetor i taksa paguesit duke shumëzuar bazën e taksës (gjatësinë lineare për kilometër) me nivelin tregues të saj.

**Niveli i kësaj takse eshte:**

- Për linjat nëntokësore 1000 lekë/km/vit
- Për linjat ajrore. 2000 leke/km/vit

➤ Struktura pergjegjese e ngarkuar mbledhjen e kesaj takse

- per identifikimin e linjave ekzistuese dhe atyre te reja eshte IMT
- për përlllogaritjen e taksës së perkohshme për linjat ajrore dhe nëntokësore eshte DPKZHT
- per vjeljen e saj është Drejtorja e Tatim-Taksave të Bashkisë Kruje.

## Të Ardhura Nga Taksa Kombetare

## 9. TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA.

Detyrimi për pagimin e taksës i takon pronarit të mjetit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

❖ **Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:**

**Agjenti tatimor për vjeljen e taksës vjetore për mjetet e përdorura është Drejtoria Rrugore e Transportit, e cila i perfiton 18 % e vlerës së arketuar të taksës së njesive vendore, për mjetet që janë në territorin e saj.**

Drejtoria e Tatim-Taksave pranë Bashkisë ben rakordimet me DSHTR dhe planifikimin e të ardhurave për këto takse.

## **10 .TAKSA E RENTES MINERARE**

Të gjithë personat fizikë ose juridikë, që janë të licencuar dhe veprojnë në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë, duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka.

Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare.

❖ **Strukturat përgjegjëse për vjeljet e taksës:**

Në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit, struktura përgjegjëse për arketimin e kësaj takse është Drejtoria Rajonale Tatimore.

Në rastin e eksportit të produkteve minerare , struktura përgjegjëse për arketimin e kësaj takse janë Degët e Doganave në rrethe.

Drejtoria e Tatim-Taksave pranë Bashkisë ben rakordimet me degen e thesarit dhe planifikimin e të ardhurave për këto takse.

## **II TARIFA VENDORE**

Mbeshtet në nenin 35 të ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Si dhe pikës 3 të nenit 16 të ligjit nr.8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”.

- Në mbështetje të ligjeve të sipër cituar , Bashkia krijon të ardhura nga tarifatat vendore për:

- a) shërbimet publike që ato ofrojnë;
- b) të drejtën e përdorimit të pronave publike vendore;
- c) dhënien e licencave, të lejeve, autorizimeve dhe për lëshimin e dokumenteve të tjera, për të cilat ato kanë autoritet të plotë.

Ky kapitull trajton tarifatat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët:

Llojit, baze të taksueshëm, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

### **1. Tarife për zënie të hapësirave publike**

- Bazuar ne ligjin 142/2015 “Per disa ndryshime dhe shtesa ne ligjin ne ligjin 9632 dt 30.10.2006.”PER SISTEMIN E TAKSAVE VENDORE”i ndryshuar
- Kjo tarife paguhet për zënien e hapësirave publike për qëllime biznesi
- Tarifa llogaritet si detyrim mujor i tatimpaguesit.  
Baza e taksës për zënie të hapsirave publike është sipërfaqja në m2, e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi e dhene me kontratë nga Bashkia per ushtrim aktivitet biznesi.

Këshilli Bashkiak vendos për nivelin, rregullat bazë për administrimin dhe mbledhjen e kësaj tarife, si dhe mund të caktojë nivele të ndryshme të kësaj tarife, sipas nivelit të zhvillimit të veprimtarisë së biznesit në zona të ndryshme të qendrës së banuar.

- **Tarifa për zënien e hapësirës publike nuk zbatohet për hapësirat që nuk janë në pronësi dhe nën administrimin e pushtetit vendor.”.**

#### **Niveli tregues i takses**

